

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKA I TEKNOLOGJISË MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS - SEKTORI I ARKIVËS - ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	018 2 Prishtinë / a
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No. Data Datum Date	1774 16, 06, 20 17



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku
 i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology**

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 15 qershor 2015
 Ref. 236/018

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 8 (1.4) dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dt. 22.03.2011, nenit 5 (5) të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimi Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Udhëzimit Administrativ 10/2008 për emërtimin dhe riemërtimin e shkollave dhe në bazë të kërkesës së DKA-së në Gjilan nr. 1669 të datë: 18.05.2015, nxjerr:

V E N D I M

1. Shkolla e Mesme e Lartë "Gjimnazi Natyror" në Gjilan emërtohet si Shkolla e Mesme e Lartë "Xhavit Ahmeti".
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara dhe kërkesën e DKA-së në Gjilan nr. 1669, dt. 18.05.2015, kërkesën e Këshillit të Shkollës së Mesme të Lartë në Gjilan nr. 10/15, dt. 05.05.2015, Komisioni për Emërtimin dhe Riemërtimin e Shkollave në MASHT, në mbledhjen e mbajtur më 03.06.2015, shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në MASHT dhe konstatoi se lënda ka kaluar nëpër procedurë të rregullt. Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, ka përkrahur propozimet dhe ka rekomanduar propozimin e bërë nga Këshilli i Shkollës të cilin e ka arsyetuar me shkrim në kërkesën e dorëzuar në MASHT, prandaj Komisioni i MASHT miratoi propozimin që Shkolla e Mesme e Lartë të emërtohet "Xhavit Ahmeti". Duke u mbështetur në këto argumente, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 30 ditësh në Komisionin për ankesa dhe parashtresa në MASHT.

Arsim BAJRAMI

Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Vendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gjilan;
2. Shkollës e Mesme e Lartë në Gjilan;
3. Komisionit për Emërtimin dhe Riemërtimin e Shkollave në MASHT;
4. Arkivit në MASHT.